

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

NR.711 DATE 21.10.1996

P E R

DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE
NR.360,DATE 10.7.1995 "PER REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA
DHE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE",NDRYSHUAR ME VENDIMIN
NR.415, DATE 7.8.1995, DHE VENDIMIN NR.121, DATE 12.2.1996

Me propozimin e Ministrise se Industrise, Transportit dhe
Tregtise, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr.360, date
10.7.1995 "Per regjimin e eksport-importit nga dhe ne
Republiken e Shqiperise", ndryshuar me vendimin nr.415, date
7.8.1995, dhe vendimin nr.121, date 12.2.1996, te behen keto
ndryshime:

a) Ne piken 2, paragrafi me permbajtjen:

"Dru i sharruar apo i prere per se gjati, i prere ne
feta apao i qeruar, nese eshte apo jo zdrukthtuar, poliruar me
shpan apo ngjitur nga kllapat bashkuese te nje trashesie me
teper se 6mm" ndryshohet dhe zevendesohet me paragrafin e
meposhtem:

"Dru i sharruar ose i prere per se gjati, i kthyerne feta
ose flete, edhe i planosur, i pastruar ose i ngjitur me
bashkime me kapse me trashesi me te madhe se 6 mm, perjashtuar
binaret e planosur, pastruar ose ngjitur me bashkime, te cilet
lejohen te eksportohen lirisht".

b) Ne piken 2 e ketij vendimi, paragrafi i shtuar me
piken 2 te vendimit nr.121, date 12.2.1996, me klasifikimin
44.09, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Industrise, Transportit dhe
Tregtise te nxjerre udhezimin perkates.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI